

RAPORT

**MBI REZULTATET E ANKETIMIT TË
BOTËS AKADEMIKE DHE SHOQËRISË
CIVILE**

NË KUADËR TË PROJEKTIT

**“REFORMA KUSHTETUESE NGA
PERSPEKTIVA AKADEMIKE DHE
CIVIKE”**

I. HYRJJE

Projekti “Reforma kushtetuese nga perspektiva akademike dhe civike”, zbatohet nga Qendra ALTRI, me mbështetjen e Fondacionit SOROS, në kuadër të Programit ‘Reforma Kushtetuese’. Ndërsa Programi mbi Reformën Kushtetuese i inicuar, tashmë, nga Fondacioni SOROS, synon realizimin e një procesi të gjerë e gjithëpërfshirës, Projekti i Qendrës ALTRI, fokusohet, posaçërisht, tek përthithja e mendimeve dhe ekspertizës së botës akademike dhe shoqërisë civile mbi këtë temë. Qëllim kryesor i këtij projekti është krijimi i një koalicioni me aktorë nga bota akademike dhe organizatat e shoqërisë civile për të vjelë perspektivat e botës akademike dhe të shoqërisë civile mbi reformën kushtetuese, si dhe për të zhvilluar, formësuar dhe advokuar për një reformë të qenësishme kushtetuese, në funksion të forcimit të institucioneve dhe shtetit të së drejtës. Në funksion të realizimit të këtij qëllimi, projekti është konceptuar në tri faza: Faza 1: Anketimi; Faza 2: Fokus grupet ; dhe Faza 3: Thirrja për artikuj akademikë.

Në kuadër të **Fazës 1:Anketimi** të Projektit u anketuan përfaqësues të botës akademike dhe shoqërisë civile. Nën qëllimin kryesor të Projektit, **Objektivat specifike** që synohet të realizohen përmes kësaj Faze të Projektit janë:

- ☞ *Vendosja e dialogut me aktorë të botës akademike dhe të shoqërisë civile për të kuptuar perceptimin e tyre në lidhje me nevojën për reformë kushtetuese, si dhe për të marrë perceptimin dhe perspektivat e tyre mbi si do duhej realizuar kjo reformë;*
- ☞ *Nxijtja e debateve dhe diskutimeve në rrethet akademike dhe të shoqërisë civile për një reformë të qenësishme kushtetuese me synim rivendosjen e sistemit të kontrollit dhe baraspeshimit të pushteteve.*

Rezultatet e pritshme nga kjo veprimtari specifike ishin:

- ✓ *Përfitimi i perspektivës akademike dhe të shoqërisë civile mbi reformën kushtetuese;*
- ✓ *Gjallërimi i debatit publik, me fokus tek rrethet akademike, shoqëria civile dhe praktikantët e ligjit, mbi reformën kushtetuese.*

Në këtë dokument bëhet një përmbledhje e rezultateve të këtij anketimi. Në pjesën e parë, përshkruhet Pyetëtori i përdorur në këtë proces dhe metodologjia e analizimit të të dhënave,

ndërsa në pjesët në vijim evidentohen rezultatet e mbledhura përmes Pyetësorit. Bazuar në mendimet e të anketuarve, në pjesën e fundit të këtij Raporti, evidentohen Përfundimet.

II. PYETËSORI DHE METODOLOGJIA E ZHVILLIMIT TË ANKETIMIT DHE E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE

Në përputhje me aktivitetet e planifikuara për Fazën 1 të Projektit “*Reforma kushtetuese nga perspektiva akademike dhe civike*”, Fondacioni SOROS hartoi **Pyetësorin Reforma Kushtetuese – Një Prioritet Aktual apo i Parakohshëm?** (shih Aneksin nr. 1) Qëllimi i këtij Pyetësori ishte:

☞ ***Matja dhe vlerësimi i perceptimit dhe të kuptuarit që kanë grupe të ndryshme interesi mbi nevojën për një reformë rrënjësore kushtetuese, si kusht për rivendosjen e sistemit të kontrollit dhe balancimit të pushteteve, suksesin në reformën në drejtësi dhe luftën ndaj korrupsionit.***

Në funksion të qëllimeve të lartpërmendura, me një total prej 35 pyetjesh, Pyetësori u konceptua në disa grupe pyetjesh, si më poshtë:

1. Informacion i përgjithshëm;
2. Seksioni I – Nevoja për ndryshime kushtetuese dhe fushat ku duhet të fokusohet reforma.
3. Seksioni II – Procedura që duhet të ndiqet për ndryshimin e Kushtetutës.
4. Seksioni III – Propozime mbi ndryshimet potenciale kushtetuese.

Grupi i parë përmban **9 pyetje** që synojnë të evidentojnë informacione të përgjithshme mbi të anketuarit të tilla si mosha, gjinia, pozicioni, institucioni, rrethi, vitet e përvojës profesionale, arsimit, hierarkia. **Grupi i dytë** i pyetjeve që korrespondon me **Seksionin I – Nevoja për ndryshime kushtetuese dhe fushat ku duhet të fokusohet reforma** të Pyetësorit, përmban **4 pyetje** që synojnë të evidentojnë nëse të anketuarit e shohin apo jo si të nevojshëm ndryshimin e Kushtetutës, nëse mendojnë se ky ndryshim duhet të jetë i plotë apo i pjesshëm, nëse janë pro

apo kundër rikthimit të Kushtetutës në versionin e para ndryshimeve të vitit 2008 dhe mbi cilat aspekte të Kushtetutës mendojnë se duhet të ketë ndryshime. **Grupi i tretë** i pyetjeve që korrespondon me **Seksionin II – Procedura që duhet të ndiqet për ndryshimin e Kushtetutës** të Pyetësorit përmban **7 pyetje** që synojnë të evidentojnë mendimin e të anketuarve mbi procedurën që duhet ndjekur për amendimin e Kushtetutës, subjektet që duhet të përfshihen në proces, nevojën e pjesëmarrjes së opozitës, strukturat administruese të procesit, marrëdhëniet me publikun gjatë procesit, kriteret për përcaktimin e aspekteve të Kushtetutës që duhen rishikuar dhe mbi transparenën e informimin e publikut gjatë procesit. Grupi i katërt i pyetjeve që korrespondon me **Seksionin III – Propozime mbi ndryshimet potenciale kushtetuese** të Pyetësorit përmban **15 pyetje** që synojnë të evidentojnë qëndrimin e të anketuarve mbi ide dhe propozime konkrete për ndryshimin e Kushtetutës që lidhen me pozitën kushtetuese të Presidentit të Republikës, Kuvendin dhe reformën parlamentare, mocionin e besimit të Kryeministrit, emërimin e organeve kushtetuese dhe klauzolat për dispozitat kushtetuese të paprekshme.

Pyetësori i shpërndarë ishte **anonim**. Ndërkohë që Pyetësori është shpërndarë tek grupe të ndryshme profesionistësh, Qendra ALTRI, u kujdes për shpërndarjen e tij tek pedagogët, studentët dhe dhe prfaqësuesit e shoqërisë civile dhe analizoi të dhënat përkatëse. Ai u shpërnda në 9 fakultete juridike dhe 125 organizata të shoqërisë civile. Numri total i të anketuarve nga këto grupe është 1114.

Analiza e rezultateve, në pjesët në vijim të këtij dokumenti, trajtohet në mënyrë të veçantë për secilin nga grupet e pyetjeve të sqaruara më lart.

III. REZULTATET E ANKETIMIT

III.1 Rezultatet e Grupit I të pyetjeve: Informacion i përgjithshëm

Grupi i parë i pyetjeve, i përbërë nga 9 të tilla, synonte të evidentonte informacione të përgjithshme mbi të anketuarit të tilla si mosha, gjinia, pozicioni, institucioni, rrethi, vitet e përvojës profesionale, arsimi, hierarkia. Në përputhje me metodologjinë e Projektit, për një kampion sa më të konsiderueshëm të përfaqësuesve të secilit grup (studentë, pedagogë, përfaqësues të shoqërisë civile), shumica e të anketuarve nga bota akademike i përkasin fakulteteve juridike dhe një pjesë e tyre edhe degës së Shkencave Politike të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe numri më i lartë i të anketuarve nga ky grup përbëhet nga studentët.

Konkretisht, nga përpunimi i të dhënave të kësaj pjese të Pyetësorit rezulton se nga 1114 të anketuarit nga bota akademike dhe shoqëria civile:

- ☞ **112 ose 10,5%** e të anketuarve janë **pedagogë**;
- ☞ **842 ose 75,58%** e të anketuarve janë **studentë**;
- ☞ **160 ose 14,36%** e të anketuarve janë **përfaqësues të shoqërisë civile**.

Sa i takon institucioneve/organizatave ku të anketuarit studiojnë ose punojnë, rezulton se:

- ☞ **823 ose 73,88%** e tyre studiojnë/punojnë në **fakultete të drejtësisë**;
- ☞ **134 ose 12,03%** e tyre studiojnë/punojnë në degën e **Shkencave Politike (Fakultet i Shkencave Sociale)**;
- ☞ **157 ose 14,09%** e tyre punojnë në **organizata jofitimprurëse**.

Rrethet në të cilat u shtri anketimi, për shkak të shpërndarjes gjeografike së fakulteteve juridike në vend, ishin: **Tirana, Durrësi, Vlora dhe Shkodra**.

Sa i takon **gjinisë** së të anketuarve **689 ose 61,85%** e tyre janë femra dhe **425 ose 38,15%** e tyre janë meshkuj. Ndërsa rezultatet sipas **grupmoshave**, janë si më poshtë:

- ☞ 790 ose 70,92% e të anketuarve janë nën moshën 30 vjec, e dhënë kjo që lidhet me numrin më të lartë të anketuarve nga radhët e studentëve;
- ☞ 222 ose 19,93% e të anketuarve janë i përkasin grupmoshës 30-40 vjec;
- ☞ 66 ose 9,92% e të anketuarve i përkasin grupmoshës 41-50 vjec; dhe
- ☞ 36 ose 3,23% e të anketuarve i përkasin grupmoshës mbi 50 vjec.

Duke qenë se shumica e të anketuarve ishin studentë, sa i takon përvojës profesionale, numrin më të lartë, 601 ose 53,95% e përbëjnë të anketuarit **pa përvojë profesionale**. Gjithsesi, bie në sy një numër më i ulët të anketuarish pa përvojë profesionale në raport me numrin e përgjithshëm të të anketuarve dhe numrin e studentëve, që do të thotë se ndonëse studentë, një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë tashmë edhe përvojë profesionale. Në radhët e të anketuarve me përvojë profesionale, shpërndarja e viteve të punës është si më poshtë:

- ☞ 233 ose 20,92% e të anketuarve kanë 1-4 vjet përvojë profesionale;
- ☞ 127 ose 11,40% e të anketuarve kanë 5-9 vjet përvojë profesionale;
- ☞ 98 ose 8,8% e të anketuarve kanë 10-15 vjet përvojë profesionale;
- ☞ 26 ose 2,33% e të anketuarve kanë 16-20 vjet përvojë profesionale;
- ☞ 29 ose 2,60% e të anketuarve kanë mbi 20 vjet përvojë profesionale.

Sa i takon studimeve:

- ☞ 755 ose 67,77% e të anketuarve kanë kryer studime universitare;
- ☞ 346 ose 31,06% kanë kryer studime pasuniversitare prej të cilëve 279 kanë kryer studime të ciklit të dytë – Master dhe 67 studime të ciklit të tretë – Doktoraturë.

Pyetjet e Pyetësorit në lidhje me hierarkinë dhe profiling nuk u përfshinë në anketimin e botës akademike dhe shoqërisë civile.

Nga sa më sipër, rezultatet e kësaj pjese të pyetësorit dëshmojnë për **një përqindje më të lartë të të anketuarve nga radhët e:**

- ✓ studentëve (75,58%);
- ✓ atyre që studiojnë/punojnë në fakultete të drejtësisë (73,88%);

- ✓ femrave (61,85%);
- ✓ personave nën moshën 30 vjec (70,92%);
- ✓ personave pa përvojë profesionale (53,95%);
- ✓ personave që kanë kryer studime universitare (67,77%).

III.2 Rezultatet e Grupit II të pyetjeve: Seksioni I - Nevoja për ndryshime kushtetuese dhe fushat ku duhet të fokusohet reforma

Grupi i dytë i pyetjeve që korrespondon me *Seksionin I – Nevoja për ndryshime kushtetuese dhe fushat ku duhet të fokusohet reforma* të Pyetësorit, përmes **4 pyetjeve**, synojnë të evidentonte qëndrimin e të anketuarve mbi nevojën e ndryshimit të Kushtetutës dhe shtrirjen e këtij ndryshimi.

Nga 1114 të anketuar, në lidhje me nevojën për ndryshim kushtetues:

- ☞ 741 ose 66,52% janë dakord;
- ☞ 238 ose 21,36 nuk janë plotësisht dakord;
- ☞ 80 ose 7,18% nuk janë dakord;
- ☞ 33 ose 2,96% janë përgjigjur me ‘nuk e di’; dhe
- ☞ 22 ose 1,97% kanë refuzuar të përgjigjen.




Pyetjes nëse rishikimi i Kushtetutës, duhet të jetë i plotë apo i pjesshëm:

- ☞ 216 ose 19,39% i janë përgjigjur se ndryshimi duhet të jetë **i plotë**;
- ☞ 730 ose 65,53% i janë përgjigjur se ndryshimi duhet të jetë **i pjesshëm**;
- ☞ 82 ose 7,36% i janë përgjigjur me **'nuk e di'**;
- ☞ 6 ose 0,54% kanë zgjedhur opcionin **'refuzoj të përgjigjem'**; dhe
- ☞ 80 ose 7,18% nuk i janë përgjigjur fare (**nuk kanë zgjedhur asnjë opcion**).



Pyetjes nëse kjo (ndryshimi) nënkupton rikthimin e Kushtetutës përpara ndryshimeve të vitit 2008:

- ☞ 167 ose 14,99% e të anketuarve i janë përgjigjur me **'Po'**;
- ☞ 648 ose 58,17% i janë përgjigjur me **'Jo'**;
- ☞ 213 ose 19,12% i janë përgjigjur me **'nuk e di'** dhe
- ☞ 6 ose 0,54% kanë refuzuar të përgjigjem.



Pyetjes se cilat aspekte të Kushtetutës duhen ndryshuar:

- ☞ 176 ose 15,8% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Modeli parlamentar i qeverisjes**’
- ☞ 332 ose 29,80% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Sistemi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve**’;
- ☞ 342 ose 30,7% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Pozita kushtetuese e Presidentit të Republikës**’;
- ☞ 365 ose 32,76% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Emërimi i anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese**’;
- ☞ 462 ose 41,47% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Rregullimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së pushtetit gjyqësor**’;
- ☞ 117 ose 10,05% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Dispozitat lidhur me Këshillin e Ministrave**’;
- ☞ 239 ose 21,25 % e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Emërimi dhe pozita kushtetuese e Prokurorit të Përgjithshëm dhe sistemit të prokurorisë**’;
- ☞ 289 ose 25,94% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Pozicioni dhe garancitë kushtetuese të institucioneve të pavarura Rregullimi i organizimit të pushtetit vendor**’;
- ☞ 230 ose 20,65% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Rregullimi i organizimit të pushtetit vendor**’;
- ☞ 183 ose 16,43% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Procesi ligjvënës**’;
- ☞ 90 ose 8,08% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Kreu mbi referendumin**’;
- ☞ 26 ose 2,33% i janë përgjigjur me opcionin ‘**të tjera**’ duke listuar tematika të tilla si: *zgjedhja e presidentit, administrata publike, arsimi, liritë dhe të drejtat e njeriut, objektivat sociale, garantimi i pavarësisë së organeve të pushtetit vendor nga ndryshimi i maxhorancave qeveritare, neni 116 në lidhje me vendimet e GjED dhe burimeve parësore dhe dytësore të së drejtës sipas perspektivës së integritetit evropian të vendit, forma e qeverisjes (republikë presidenciale), dispozitat mbi KLSH, të gjitha, sistemi zgjedhor, mandati urdhërues.*

Nga sa më sipër, rezulton se:

- ✓ Shumica e të anketuarve (66,52%) janë dakord me opinionet që konsiderojnë të nevojshëm rishikimin e Kushtetutës;
- ✓ Shumica e të anketuarve (65,53%) menodjnë se rishikimi duhet të jetë i pjesshëm;
- ✓ Shumica e të anketuarve (58,17%) nuk e shohin rishikimin si rikthim në versionin e Kushtetutës si para ndryshimeve të vitit 2008.
- ✓ Sa i takon aspekteve mbi të cilat duhet të shtrihet ndryshimi, duket se shqetësim më të madh për të anketuarit përbëjnë dispozitat që lidhen me gjyqësorin, me numrin më të lartë të përgjigjeve (41,47%) mbi ‘Rregullimin e pavarësisë dhe përgjegjshëmrisë së pushtetit gjyqësor’, pasuar nga përgjigja ‘Emërimi i anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese’ (me 32,76%). Një çështje tjetër më interes duket të jetë edhe pozita kushtetuese e Presidentit të Republikës (me 30,7%). Të gjitha aspektet e tjera rezultojnë me një përqindje nën 30%.


III. 3 Rezultate e Grupit III të pyetjeve: Seksioni II - Procedura që duhet të ndiqet për ndryshimin e Kushtetutës

Grupi i tretë i pyetjeve që korrespondon me *Seksionin II – Procedura që duhet të ndiqet për ndryshimin e Kushtetutës* të Pyetësorit, përmes 7 pyetjeve, synonte të evidentonte qëndrimin e të anketuarve mbi aspekte të procedurës që duhet ndjekur për amendimin e Kushtetutës, subjekteve të përfshira, administrimit të procesit dhe informimit të publikut.

Pyetjes se *cila prej procedurave të parashikuara në Kushtetutë, iu dukej më e përshtatshme për amendimin*, të anketuarit i janë përgjigjur si më poshtë:

- ☞ 312 ose 28,01% kanë zgjedhur opcionin ‘Votimi në Kuvend me shumicën prej 2/3 të anëtarëve të tij’;
- ☞ 436 ose 39,14% kanë zgjedhur opcionin ‘Votimi në Kuvend me shumicën prej 2/3 të anëtarëve të tij për hedhjen e amendamenteve në referendum’;
- ☞ 278 ose 24,96% kanë zgjedhur opcionin ‘Votimi në Kuvend me shumicën prej 2/3 të anëtarëve të tij dhe hedhja e amendamenteve në referendum me kërkesën e pakicës që i kundërshtoi ato’;

- ☞ 1 ose 0,09% kanë zgjedhur opcionin ‘Nuk e di’;
- ☞ 7 ose 0,63% kanë zgjedhur opcionin ‘Refuzoj të përgjigjem’;
- ☞ 80 ose 7,18% nuk i janë përgjigjur fare pyetjes.



Sa i takon pyetjes ***mbi subjektet që duhet të përfshihen në procesin e diskutimit dhe hartimit të amendamenteve kushtetuese***, rezultatet janë si më poshtë (të anketuarit mund të zgjidhnin më shumë se një opcion):

- ☞ 340 ose 30,52% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘Anëtarë të parlamentit aktual’;
- ☞ 239 ose 21,45% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘Anëtarë të parlamentit në legjislaturat e kaluara, ish-presidentë, ish-kryeministra’;
- ☞ 214 ose 19,21% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘Përfaqësues të qeverisë’;
- ☞ 324 ose 29,08% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘Përfaqësues të pushtetit gjyqësor’;
- ☞ 626 ose 56,19% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘Aktorë të tjerë të rëndësishëm si akademikë, konstitucionalistë dhe ekspertë të fushës’;
- ☞ 396 ose 35,55% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘Përfaqësues të grupeve të interesit’;
- ☞ 408 ose 36,62% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘Përfaqësues të shoqërisë civile’;
- ☞ 408 ose 36,62% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘Konsulentë të huaj’;

- ☞ 192 ose 17,24% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Publiku i gjerë**’;
- ☞ 7 ose 0,63% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Të tjerë**’ duke specifikuar të gjithë të mësipërmit, studentët e drejtësisë, organizatat joqeveritare, grupet vulnerabël, persona publikë të besueshëm.

Në Pyetësor përfshihej edhe një pyetje që përmbante një rast hipotetik – situatën ku mazhoranca parlamentare siguron numrin e mjaftueshëm të votave për miratimin e ndryshimeve kushtetuese. Të anketuarit janë pyetur mbi **si e vlerësojnë rolin e opozitës**, nëse do të vërtetohej një hipotezë. Ata u përgjigjën:

- ☞ 418 ose 37,52% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Shumë të rëndësishme**’;
- ☞ 366 ose 32,85% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Të rëndësishme**’;
- ☞ 143 ose 12,84% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Mjaftueshëmrisht të rëndësishme**’;
- ☞ 76 ose 6,82% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Aspak të rëndësishme**’;
- ☞ 26 ose 2,33% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Nuk e di**’;
- ☞ 5 ose 0,45% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘**Refuzoj të përgjigjem**’.



Pyetjes se **cila ju dukej struktura më e përshtatshme për administrimin e procesit të amendimit të Kushtetutës**, të anketuarit iu përgjigjën:

- ☞ 161 ose 14,45% ‘**Komisioni parlamentar i Ligjeve**’;

- ☞ 592 ose 53,14% ‘Një komision parlamentar i posaçëm me pjesëmarrje të barabartë nga forcat politike’;
- ☞ 66 ose 5,92% ‘Këshilli i Ministrave’;
- ☞ 171 ose 15,35% ‘Një organizatë ndërkombëtare’;
- ☞ 43 ose 3,86% zgjedhën opcionin ‘Tjetër’ duke specifikuar: (një komision ad hoc, grupe ekspertësh/konstitucionalistësh/ekspertë të së drejtës së BE-së, Këshilli i Ministrave në bashkëpunim me një organizatë ndërkombëtare, komisione ekspertësh ngritur nga Parlamenti, një komision parlamentar i posaçëm me pjesëmarrje të barabartë nga forcat politike dhe ekspertë të fushës, komision jashtë parlamentit, komision i posaçëm i përbërë nga konstitucionalistë dhe ekspertë të huaj e ish-deputetë të legjislaturave të mëparshme, Parlamenti dhe Këshilli i Ministrave së bashku me një organizatë ndërkombëtare, akademikë, përfaqësues të shoqërisë civile, institucion shtetëror, njerëz me moral dhe dije të larta shkencore dhe filozofike vizionare, komision me ish-deputetë, asamble kushtetuese, asnjëri nuk ka përvojë, të pavarur, asamble kombëtare dhe referendum për kushtetutë të re, komision me prakticienë, akademikë, juristë dhe një organizatë ndërkombëtare, grupet e interesit, komision me përfaqësues të shoqërisë civile, refuzoj të përgjigjem);
- ☞ 81 ose 7,27% nuk i janë përgjigjur pyetjes.

Pyetjes mbi *institucionin/aktorin që duhet të kryejë administrimin e marrëdhënieve me publikun gjatë procesit të diskutimeve për rishikimin e Kushtetutës*, të anketuarit iu përgjigjën:

- ☞ 278 ose 24,96% ‘Aktor i shoqërisë civile’;
- ☞ 243 ose 21,81% ‘Institucion shtetëror’;
- ☞ 206 ose 18,49% ‘Parlamenti’;
- ☞ 283 ose 25,40% ‘Organizatë ndërkombëtare’;
- ☞ 24 ose 2,15% kanë zgjedhur opcionin ‘Tjetër’ duke specifikuar: akademikët, grup pune me ekspertë konstitucionalistë, media vizive dhe e shkruar, institucion i posaçëm me përfaqësues të institucioneve relevante shtetërore dhe përfaqësues të shoqërisë civile, grupeve të inreresit etj., Ministrat, Organizatë e pavarur vendase, Komision përkatës, akademikë, ekspertë, organ i posaçëm me pjesëmarrës nga të dyja forcat politike,

përfaqësues të shoqërisë, organ ad hoc me ekspertë dhe konstitucionalistë, Grup i posacëm pune, asnjëri nga opcionet, person i caktuar vetëm për këtë qëllim, larg politikës, të pavarur, një institucion i posacëm, refuzoj të përgjigjem.

Të anketuarit u pyetën gjithashtu ***mbi kriteret që ju duken të përshtatshme për të përcaktuar aspektet që duhen rishikuar në Kushtetutë*** (ata mund të zgjidhnin më shumë se një opcion).

Rezultatet janë si më poshtë:

- ☞ 526 ose 47,22% e të anketuarve kanë zgjedhur si kriter **‘Problematika e vërejtur në zbatimin e Kushtetutës’**;
- ☞ 535 ose 48,03% e të anketuarve kanë zgjedhur si kriter **‘Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut’**;
- ☞ 235 ose 21,10% e të anketuarve kanë zgjedhur si kriter **‘Raportet dhe komentet e organizatave ndërkombëtare’**;
- ☞ 297 ose 26,6% e të anketuarve kanë zgjedhur si kriter **‘Kontributet akademike dhe përvoja e vendeve të tjera’**;
- ☞ 395 ose 35,46% e të anketuarve kanë zgjedhur si kriter **‘Raport progreset e Bashkimit European’**;
- ☞ 11 ose 0,99% e të anketuarve zgjidhën opcionin **‘Të tjera’** duke specifikuar kritere të tilla si: të gjitha, kompetencat e Parlamentit dhe të Kryeministrit, Komisioni i Venecias, Përfshirje më e gjerë e të drejtave të njeriut (mjet ankimi efektiv në Gjykatën Kushtetuese), Asnjëri nga opcionet, Refuzoj të përgjigjem.

Pyetjes se ***si e vlerësojnë transparencën dhe informimin aktiv të publikut dhe grupeve të interesit për procesin e ndryshimeve kushtetuese***, të anketuarit iu përgjigjën:

- ☞ 737 ose 66,16% **‘Shumë të rëndësishme’**;
- ☞ 222 ose 19,93 **‘Të rëndësishme’**;
- ☞ 59 ose 5,30% **‘Mjaftueshmërisht të rëndësishme’**;
- ☞ 12 ose 1,08 **‘Aspak të rëndësishme’**;
- ☞ 4 ose 0,36% **refuzuan të përgjigjen.**



Nga analiza e këtij grupi pyetjesh, rezulton se:

- ✓ Shumica e të anketuarve (39,14%), shohin si **procedurë më të përshtatshme** për ndryshimin e Kushtetutës atë të **‘Votimit në Kuvend me shumicën prej 2/3 të anëtarëve të tij për hedhjen e amendamenteve në referendum’**;
- ✓ Shumica e të anketuarve (56,19%) mendojnë se **subjektet** që duhet të përfshihen në procesin e diskutimit dhe hartimit të amendamenteve kushtetuese duhet të jenë **‘Aktorë të tjerë të rëndësishëm si akademikë, konstitucionalistë dhe ekspertë të fushës’**;
- ✓ Shumica e të anketuarve (37,52%), në eventualitetin që mazhoranca ka shumicën e nevojshme për amendimin e Kushtetutës, e shohin **pjesëmarrjen e opozitës** si **‘Shumë të rëndësishme’**;
- ✓ Shumica e të anketuarve (53,14%), si **strukturën** më të përshtatshme për administrimin e procesit të amendimit të Kushtetutës, shohin **‘Një komision parlamentar të posaçëm me pjesëmarrje të barabartë nga forcat politike’**;
- ✓ Shumica e të anketuarve (25,40%) si **aktorin/institucion** që duhet të kryejë administrimin e procesit të marrëdhënieve me publikun gjatë procesit të rishikimit të Kushtetutës, shohin **‘Organizatë ndërkombëtare’**;
- ✓ Shumica e të anketuarve (48,03%) konsiderojnë si **kriter** më të përshtatshëm për të përcaktuar aspektet që duhen rishikuar në Kushtetutë **‘Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut’**;
- ✓ Shumica e të anketuarve (66,16%) e konsiderojnë **transparencën dhe informimin aktiv** të publikut dhe grupeve të interesit **‘Shumë të rëndësishme’**.


III. 4 Rezultatet e Grupit IV të pyetjeve: Seksioni III - Propozimet mbi ndryshime potenciale kushtetuese

Grupi i katërt i pyetjeve që korrespondon me **Seksionin III – Propozime mbi ndryshimet potenciale kushtetuese** të Pyetësorit, përmes **ba 15 pyetjeve**, synojnë të evidentonte qëndrimin e të anketuarve mbi propozime konkrete për ndryshimin e Kushtetutës që lidhen me pozitën kushtetuese të Presidentit të Republikës, Kuvendin dhe reformën parlamentare, mocionin e besimit të Kryeministrit, emërimin e organeve kushtetuese dhe klauzolat për dispozitat kushtetuese të paprekshme. Rezultatet e bllokut të përgjigjeve për secilën nga këto çështje, janë si më poshtë:

❖ POZITA KUSHTETUESE E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS


Në lidhje me pozitën kushtetuese të Presidentit të Republikës, të anketuarve iu drejtuan tri pyetje në lidhje me formën e zgjedhjes së Presidentit dhe kompetencat e tij. Sa i takon pyetjes, nëse mendojnë se **duhet ndryshuar formula aktuale e zgjedhjes së Presidentit në funksion të forcimit të rolit të tij si një figurë e paanshme politikisht dhe garant i Kushtetutës**, të anketuarit u përgjigjën si më poshtë:

- ☞ 758 ose **68,04%** e të anketuarve mendojnë se ‘**Po**’;
- ☞ 203 ose **18,22%** e të anketuarve mendojnë se ‘**Jo**’;
- ☞ 68 ose **6,10%** e të anketuarve janë përgjigjur me ‘**Nuk e di**’;
- ☞ 5 ose **0,45%** e të anketuarve kanë **refuzuar** të përgjigjen.



Në vijim, të anketuarit u pyetën se ***cilin variant për zgjedhjen e Presidentit do të vlerësonin të përshtatshëm për sistemin shqiptar***. Përgjigjet e tyre ishin si më poshtë:


- ☞ 173 ose 15,53% e të anketuarve shohin si të përshtatshme ‘Zgjedhjen e Presidentit nga tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit’;
- ☞ 666 ose 59,78% e të anketuarve shohin si të përshtatshme ‘Zgjedhjen e Presidentit drejtpërdrejtë nga populli’;
- ☞ 145 ose 13,02% e të anketuarve shohin si të përshtatshme ‘Zgjedhjen e Presidentit sipas formulës aktuale’;
- ☞ 9 ose 0,81% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘Tjetër’ duke specifikuar variante të tilla si: Konsensual, me unanimitet, 4/5 e Parlamentit dhe nëse nuk zgjidhet nga 4/5 të zgjidhet nga populli, sic ishte para ndryshimeve të 2008, sipas formule aktuale por mazhoranca zgjedh njërin midis 5 kandidatëve personalitete të shquara të propozuara vetëm nga opozita., mazhoranca me propozim të opozitës zgjedh 1 nga 5 kandidatët (personalitete të shquara), 2/3 e anëtarëve të Kuvendit.;
- ☞ 34 ose 3,05% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin ‘Nuk e di’;
- ☞ 7 ose 0,63% e të anketuarve kanë **refuzuar** të përgjigjen.



Krahas, formulës së zgjedhjes, të anketuarit u pyetën edhe ***nëse mendonin se duhet të ndryshojnë kompetencat kushtetuese të Presidentit të Republikës***. Ata u përgjigjën kështu:

- ☞ 575 ose 51,62% zgjedhën opcionin ‘Po, duhet të jenë më të zgjeruara’;
- ☞ 138 ose 12,39% zgjedhën opcionin ‘Po, duhet të jenë më të kufizuara’;

- ☞ 232 ose 20,83 zgjodhën opcionin ‘Jo’;
- ☞ 84 ose 7,54 zgjodhën opcionin ‘Nuk e di’;
- ☞ 5 ose 0,45 zgjodhën **refuzuan** të përgjigjen.



❖ KUVENDI DHE REFORMA PARLAMENTARE

Në lidhje me Kuvendin dhe Reformën parlamentare, të anketuarve iu drejtuan dy pyetje e konkretisht mbi nevojën e forcimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit dhe mbi bikameralizmin. Sa i takon pyetjes ***nëse ka nevojë për forcimin e rolit mbikëqyrës të parlamentit ndaj qeverisë***, të anketuarit u përgjigjën si më poshtë:

- ☞ 815 ose 73,16% ‘Po’;
- ☞ 120 ose 10,77% ‘Jo’;
- ☞ 93 ose 8,35% ‘Nuk e di’;
- ☞ 6 ose 0,54% refuzuan të përgjigjen.



Ndërsa sa i takon pyetjes nëse **bi-kameralizmi (parlamenti dy dhomësh)** mund të jetë më efikas për kontrollin e qeverisë, duke e bërë opozitën më pjesëmarrëse në jetën parlamentare, të anketuarit iu përgjigjën:

- ☞ 465 ose 41,74% me 'Po';
- ☞ 418 ose 37,52% me 'Jo';
- ☞ 144 ose 12,9% me 'Nuk e di';
- ☞ 7 ose 0,63% refuzuan të përgjigjen.



❖ MOCIONI I BESIMIT TË KRYEMINISTRIT

Të anketuarit u pyetën edhe mbi mocionin e besimit ndaj Kryeministrit. Të pyetur për **mendimin e tyre mbi formulimin aktual të dispozitës kushtetuese mbi mocionin e besimit ndaj Kryeministrit (në rast se mocioni i besimit i paraqitur në Kuvend nga Kryeministri votohet nga më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, ai ka të drejtë t'i kërkojë Presidentit të Republikës shpërndarjen e Kuvendit)**, të anketuarit u shprehën si më poshtë:

- ☞ 425 ose 38,15% mendojnë se 'është forcuar pozita e Kryeministrit në dëm të qëndrueshmërisë së qeverisjes';
- ☞ 324 ose 29,08% mendojnë se 'është rritur standardi politik dhe stabiliteti në vend';
- ☞ 277 ose 24,87% kanë zgjedhur opcionin 'Nuk e di';
- ☞ 8 ose 0,72% refuzuan të përgjigjen.

Në vijim, të anketuarit u pyetën se **cilin shohin si sistemin më të përshtatshëm për çështjen e mocionit të besimit/mosbesimit të Kuvendit ndaj Kryeministrit**. Ata u përgjigjën si më poshtë:

- ☞ 353 ose 31,69% zgjodhën ‘Në qoftë se Kryeministri e humbet votëbesimin dhe Kuvendi nuk është në gjendje të miratojë menjëherë një Kryeministër të ri, vendi shkon në zgjedhje të reja (sistemi aktual)’;
- ☞ 301 ose 27,02% zgjodhën ‘Në qoftë se Kryeministri e humbet votëbesimin, Kuvendi ka një hapësirë kohore për të zgjedhur një Kryeministër të ri (sistem i mëparshëm)’;
- ☞ 274 ose 24,60% zgjodhën ‘Në qoftë se Kryeministri e humbet votëbesimin, ai qëndron në detyrë deri në zëvendësimin e tij nga Kryeministri tjetër i ri’;
- ☞ 98 ose 8,8% zgjodhën ‘Nuk e di’;
- ☞ 8 ose 0,72 refuzuan të përgjigjen.

❖ EMËRIMI I ORGANEVE KUSHTETUESE

Në vijim, paraqiten rezultatet e përgjigjeve për një sërë pyetjesh në lidhje me organet kushtetuese.

Të anketuarit u pyetën nëse duhet ndryshuar formula aktuale e zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, të gjykatës së lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm duke qenë se sipas sistemit aktual kushtetues, zgjedhja e gjyqtarëve kushtetues dhe të lartë si dhe Prokurorit të Përgjithshëm, (megjithëse bazohet në sistemin e përzier President - Kuvend) realizohet me një minimum prej 36 votash të deputetëve të Kuvendit. Të anketuarit u përgjigjën si vijon:

► *Në lidhje me gjyqtarët kushtetues:*

- ☞ 757 ose 67,95% u përgjigjën me ‘Po’;
- ☞ 196 ose 17,59% u përgjigjën me ‘Jo’;
- ☞ 72 ose 6,46% u përgjigjën me ‘Nuk e di’;
- ☞ 9 ose 0,81% refuzuan të përgjigjen.

► *Në lidhje me gjyqtarët e Gjykatës së Lartë:*

- ☞ 757 ose 67,95% u përgjigjën me ‘Po’;
- ☞ 210 ose 18,85% u përgjigjën me ‘Jo’;
- ☞ 72 ose 6,46% u përgjigjën me ‘Nuk e di’;

☞ 9 ose 0,81% refuzuan të përgjigjen.

► **Në lidhje me Prokurorin e Përgjithshëm?**

☞ 729 ose 65,44% u përgjigjën me 'Po';

☞ 208 ose 18,67% u përgjigjën me 'Jo';

☞ 88 ose 7,9% u përgjigjën me 'Nuk e di';

☞ 9 ose 0,81% refuzuan të përgjigjen.

Në vijim, të anketuarit u pyetën *nëse mendojnë se formula e zgjedhjes me një shumicë të cilësuar është e përshtatshme për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetuese, zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm*. Rezultatet e përgjigjeve të tyre për secilin, janë si më poshtë:

► **Në lidhje me gjyqtarët kushtetues:**

☞ 753 ose 67,59% u përgjigjën me 'Po';

☞ 194 ose 17,41% u përgjigjën me 'Jo';

☞ 77 ose 6,91% u përgjigjën me 'Nuk e di';

☞ 10 ose 0,90% refuzuan të përgjigjen.

► **Në lidhje me gjyqtarët e Gjykatës së Lartë:**

☞ 722 ose 64,81% u përgjigjën me 'Po';

☞ 222 ose 19,93% u përgjigjën me 'Jo';

☞ 80 ose 7,18% u përgjigjën me 'Nuk e di';

☞ 10 ose 0,90% refuzuan të përgjigjen.

► **Në lidhje me Prokurorin e Përgjithshëm?**

☞ 707 ose 63,46% u përgjigjën me 'Po';

☞ 225 ose 20,20% u përgjigjën me 'Jo';

☞ 92 ose 8,26% u përgjigjën me 'Nuk e di';

☞ 10 ose 0,90% refuzuan të përgjigjen.

Pyetja e radhës kishte të bënte me **verifikimin kushtetues e konkretisht nëse ky duhet të gjykohet nga Gjykata Kushtetuese apo një Kolegj i veçantë i Gjykatës së Lartë**. Përgjigjet për secilën ishin si më poshtë:

► ***Nga Gjykata Kushtetuese?***

- ☞ 817 ose 73,34% u përgjigjën me ‘Po’;
- ☞ 134 ose 12,03% u përgjigjën me ‘Jo’;
- ☞ 69 ose 6,19% u përgjigjën me ‘Nuk e di’;
- ☞ 14 ose 1,26% **refuzuan** të përgjigjen.

► ***Një kolegj i veçantë i Gjykatës së Lartë?***

- ☞ 333 ose 29,89% u përgjigjën me ‘Po’;
- ☞ 565 ose 50,72% u përgjigjën me ‘Jo’;
- ☞ 122 ose 10,95% u përgjigjën me ‘Nuk e di’;
- ☞ 14 ose 1,26% **refuzuan** të përgjigjen.

Pyetjes nëse ***Gjykata Kushtetuese duhet të shqyrtojë paraprakisht propozimet për amendimin e Kushtetutës***, të anketuarit iu përgjigjën si vijon:

- ☞ 775 ose 69,57% u përgjigjën me ‘Po’;
- ☞ 229 ose 20,56% u përgjigjën me ‘Jo’;
- ☞ 21 ose 1,89% u përgjigjën me ‘Nuk e di’;
- ☞ 9 ose 0,81% **refuzuan** të përgjigjen.

Në lidhje me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të anketuarit u pyetën nëse ***mendonin se formula aktuale e përbërjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë është e përshtatshme për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së pushtetit gjyqësor***. Ata u përgjigjën si më poshtë:

- ☞ 297 ose 26,66% u përgjigjën me ‘Po’;
- ☞ 600 ose 53,86% u përgjigjën me ‘Jo’;
- ☞ 128 ose 11,49% u përgjigjën me ‘Nuk e di’;
- ☞ 9 ose 0,81% **refuzuan** të përgjigjen.

Pyetjes *nëse mendojnë se ka nevojë për një për një ribalancim të forcave brenda Këshillit të Lartë të Drejtësisë (shumica e të cilit përbëhet nga gjyqtarë)*, të anketuarit iu përgjigjën:

- ☞ 701 ose 62,93% u përgjigjën me ‘Po’;
- ☞ 257 ose 23,07% u përgjigjën me ‘Jo’;
- ☞ 69 ose 6,19% u përgjigjën me ‘Nuk e di’;
- ☞ 7 ose 0,63% refuzuan të përgjigjen.

Ndërsa për pyetjen *në duhen ndryshuar kompetencat e Këshillit të Përgjithshëm të Prokurorisë*, të anketuarit dhanë këto përgjigje:

- ☞ 456 ose 40,93% u përgjigjën ‘Po, kompetencat e këtij mekanizmi duhen forcuar e zgjeruar’;
- ☞ 174 ose 15,62% u përgjigjën ‘Po, kompetencat e këtij mekanizmi duhen kufizuar’;
- ☞ 179 ose 16,07% u përgjigjën ‘Jo’;
- ☞ 218 ose 19,57% u përgjigjën ‘Nuk e di’;
- ☞ 7 ose 0,63% refuzuan të përgjigjen.

❖ KLAUZOLA E DISPOZITAVE KUSHTETUESE TË PAPREKSHME

Nisur nga fakti se *disa kushtetuta kanë të parashikuar ndalimin për të ndryshuar disa dispozita që lidhen me të drejtat e njeriut dhe parimet themelore*, të anketuarit u pyetën nëse mendonin se *dispozita të tilla duhet të jenë pjesë edhe e Kushtetutës sonë*. Përgjigjet e tyre ishin si më poshtë:

- ☞ 811 ose 72,80% u përgjigjën me ‘Po’;
- ☞ 142 ose 12,75% u përgjigjën me ‘Jo’;
- ☞ 72 ose 6,46% u përgjigjën me ‘Nuk e di’;
- ☞ 9 ose 0,81% refuzuan të përgjigjen.

Sa i takon pyetjeve të këtij seksioni, mund të nxirren konkluzionet e mëposhtme:

- ✓ Shumica e të anketuarve (68,04%) mendojnë se **duhet ndryshuar formula aktuale e zgjedhjes së Presidentit;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (59,78%) shohin si të përshtatshme **Zgjedhjen e Presidentit drejtpërdrejtë nga populli;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (51,62%) mendojnë se **komptencat e Presidentit duhet të ndryshojnë dhe të jenë më të zgjeruara;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (73,16%) mendojnë se **ka nevojë për forcimin e rolit mbikqyrës të Parlamentit ndaj Qeverisë;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (41,74%) mendojnë se **bi-kameralizmi (Parlamenti dy dhomësh) mund të jetë më efikas për kontrollin e qeverisë, duke e bërë opozitën më pjesëmarrëse në jetën parlamentare;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (38,15%) mendojnë se me parashikimet aktuale mbi mocionin e besimit të Kryeministrit, **është forcuar pozita e Kryeministrit në dëm të qëndrueshmërisë së qeverisjes;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (31,69%) si model të mocionit të besimit/mosbesimit parapëlqejnë variantin **‘Në qoftë se Kryeministri e humbet votëbesimin dhe Kuvendi nuk është në gjendje të miratojë menjëherë një Kryeministër të ri, vendi shkon në zgjedhje të reja (sistemi aktual)’;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (67,95%) mendojnë se **duhet ndryshuar formula aktuale e zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (67,95%) mendojnë se **duhet ndryshuar formula aktuale e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykaës së Lartë;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (65,44%) mendojnë se **duhet ndryshuar formula aktuale e zgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (67,59%) mendojnë se **formula e zgjedhjes me një shumicë të cilësuar është e përshtatshme për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetuese;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (64,81%) mendojnë se **formula e zgjedhjes me një shumicë të cilësuar është e përshtatshme për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykaës së Lartë;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (63,46%) mendojnë se **formula e zgjedhjes me një shumicë të cilësuar është e përshtatshme për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm;**

- ✓ Shumica e të anketuarve (73,34%) mendojnë se **verifikimi kushtetues duhet të ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (50,72%) **nuk** mendojnë se **verifikimi kushtetues duhet të ushtrohet nga një kolegji i vecantë i Gjykatës së Lartë;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (69,57%) mendojnë se **Gjykata Kushtetuese duhet të shqyrtojë paraprakisht propozimet për amendimin e Kushtetutës;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (53,86%) **nuk** mendojnë se **formula aktuale e përbërjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë është e përshtatshme për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së pushtetit gjyqësor;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (62,93%) mendojnë se **ka nevojë për një për një ribalancim të forcave brenda Këshillit të Lartë të Drejtësisë;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (40,93%) mendojnë se **kompetencat e Këshillit të Përgjithshëm të Prokurorisë duhen forcuar e zgjeruar;**
- ✓ Shumica e të anketuarve (72,80%) mendojnë se **Kushtetuta e Shqipërisë duhet të përmbajë klauzola të dispozitave kushtetuese të paprekshme.**

IV. PËRFUNDIME

Nga përpunimi i të dhënave të Pyetësorëve dhe analiza e tyre, arrihet në disa përfundime të rëndësishme në lidhje me mendimet e botës akademike dhe shoqërisë civile mbi Refromën Kushtetuese. Grupi prej 1114 të anketuarish me në përbërje pedagogë, studentë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, përmes pëgjigjeve të dhëna, ka evidentuar qasjet dhe mendimet e veta në lidhje me këtë Reformë, në aspekte të nevojës, zhvillimit dhe administrimit të procesit dhe përmbajtjes. Përfundimet nga analiza e këtij anketimi, paraqiten, më poshtë, në mënyrë sintetike, në tri grupe (1. Mbi nevojën e reformës kushtetuese; 2. Mbi procesin për ndryshimin e Kushtetutës; dhe 3. Mbi përmbajtjen).

1. Mbi nevojën e reformës kushtetuese

1.1 Rishikimi i Kushtetutës është i nevojshëm;

1.2 Rishikimi i Kushtetutës duhet të jetë i pjesshëm;

- 1.3 Rishikimi nuk duhet të konsistojë në rikthim në versionin e Kushtetutës si para ndryshimeve të vitit 2008;
- 1.4 Apsektet më shqetësuese, mbi të cilat duhet të shtrihet rishikimi, janë: rregullimi i pavarësisë dhe përgjegjshëmrisë së pushtetit gjyqësor, emërimi i anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, dhe pozita kushtetuese e Presidentit të Republikës.

2. Mbi procesin për ndryshimin e Kushtetutës

- 2.1 Procedura më e përshtatshme për ndryshimin e Kushtetutës është ajo e votimit në Kuvend me shumicën prej 2/3 të anëtarëve të tij për hedhjen e amendamenteve në referendum;
- 2.2 Subjektet që duhet të përfshihen në procesin e diskutimit dhe hartimit të amendamenteve kushtetuese duhet të jenë aktorë të rëndësishëm si akademikë, konstitucionalistë dhe ekspertë të fushës;
- 2.3 Edhe nëse mazhoranca ka shumicën e nevojshme për amendimin e Kushtetutës, pjesëmarrja e opozitës është shumë e rëndësishme;
- 2.4 Struktura më e përshtatshme për administrimin e procesit të amendimit të Kushtetutës, është një komision parlamentar i posaçëm me pjesëmarrje të barabartë nga forcat politike;
- 2.5 Aktori/institucioni që duhet të kryejë administrimin e procesit të marrëdhënieve me publikun gjatë procesit të rishikimit të Kushtetutës, duhet të jetë një ‘Organizatë ndërkombëtare’;
- 2.6 Kriter më i përshtatshëm për të përcaktuar aspektet që duhen rishikuar në Kushtetutë është Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- 2.7 Transparenca dhe informimi aktiv i publikut dhe grupeve të interesit gjatë procesit të ndryshimit të Kushtetutës është shumë i rëndësishëm.

3. Mbi përmbajtjen

- 3.1 Duhet ndryshuar formula aktuale e zgjedhjes së Presidentit;
- 3.2 Është më e përshtatshme zgjedhja e Presidentit drejtpërdrejtë nga populli;

- 3.3 Kompetencat e Presidentit duhet të ndryshojnë dhe të jenë më të zgjeruara;
- 3.4 Ka nevojë për forcimin e rolit mbikqyrës të Parlamentit ndaj Qeverisë;
- 3.5 Bi-kameralizmi (Parlamenti dy dhomësh) mund të jetë më efikas për kontrollin e qeverisë, duke e bërë opozitën më pjesëmarrëse në jetën parlamentare;
- 3.6 Me parashikimet aktuale mbi mocionin e besimit të Kryeministrit, është forcuar pozita e Kryeministrit në dëm të qëndrueshmërisë së qeverisjes;
- 3.7 Kushtetuta duhet të parashikojë se në qoftë se Kryeministri e humbet votëbesimin dhe Kuvendi nuk është në gjendje të miratojë menjëherë një Kryeministër të ri, vendi shkon në zgjedhje të reja (sistemi aktual);
- 3.8 Duhet ndryshuar formula aktuale e zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, gjyqtarëve të Gjykaës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm;
- 3.9 Formula e zgjedhjes me një shumicë të cilësuar është e përshtatshme për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues, e gjyqtarëve të Gjykaës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm;
- 3.10 Verifikimi kushtetues duhet të ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese. Ai nuk duhet të ushtrohet nga një koleg i vecantë i Gjykatës së Lartë;
- 3.11 Gjykata Kushtetuese duhet të shqyrtojë paraprakisht propozimet për amendimin e Kushtetutës;
- 3.12 Formula aktuale e përbërjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk është e përshtatshme për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së pushtetit gjyqësor;
- 3.13 Ka nevojë për një për një ribalancim të forcave brenda Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- 3.14 Kompetencat e Këshillit të Përgjithshëm të Prokurorisë duhen forcuar e zgjeruar;
- 3.15 Kushtetuta e Shqipërisë duhet të përmbajë klauzola të dispozitave kushtetuese të paprekshme.

ANEKS 1

Aneksi nr. 1 – PYETËSOR: REFORMA KUSHTETUESE – NJË PRIORITET AKTUAL APO I PARAKOHSHËM?

Ky pyetësor realizohet nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros me synim matjen dhe vlerësimin e perceptimit dhe të kuptuarit që kanë grupe të ndryshme interesi mbi nevojën për një reformë rrënjësore kushtetuese, si kusht për rivendosjen e sistemit të kontrollit dhe balancimit të pushteteve, suksesin në reformën në drejtësi dhe luftën ndaj korrupsionit.

Ju kujtojmë se pyetësi është anonim.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM		
Kodi	Pyetjet	Përgjigjet
1.	Pozicioni (mos e pyet)	1. Gjyqtar; 2. Prokuror; 3. Avokat; 4. Pedagog; 5. Student; 6. Përfaqësues i shoqërisë civile (OJF)
2.	Institucioni (mos e pyet)	1. Gjykata e rrethit gjyqësor; 2. Gjykata e apelit; 3. Prokuroria e rrethit gjyqësor; 4. Prokuroria e apelit; 5. Prokuroria e përgjithshme 6. Dhoma Kombëtare e Avokatisë; 7. Fakulteti i Drejtësisë 8. Fakulteti i Shkencave Sociale (dega shkenca politike) 9. Organizatë jofitimprurëse
3.	Rrethi (mos e pyet)	1. Berat 2. Dibër 3. Durrës 4. Elbasan 5. Fier 6. Gjirokastrë 7. Kavajë 8. Korçë 9. Krujë 10. Kukës 11. Kurbin 12. Lezhë 13. Lushnjë 14. Mat 15. Përmet 16. Pogradec

		17. Pukë 18. Sarandë 19. Shkodër 20. Tiranë 21. Tropojë 22. Vlorë
4.	Gjinia (mos e pyet)	1. Mashkull 2. Femër
5.	Mosha	1. Nën 30 vjeç 2. 30-40 vjeç 3. 41-50 vjeç 4. Mbi 50 vjeç
5.	Vitet e përvojës profesionale	1. Pa përvojë 2. 1-4 vjet 3. 5-9 vjet 4. 10-15 vjet 5. 16-20 vjet 6. Mbi 20 vjet
	Diploma më e lartë e marrë:	1. Universitare 2. Master 3. Doktoraturë
	Hierarkia	1. Drejtues 2. Jo drejtues
	Seksioni/Profili (pyet vetëm gjyqtarët dhe avokatët)	1. Civil 2. Penal 3. Administrativ
Seksioni I – Nevoja për ndryshime kushtetuese dhe fushat ku duhet të fokusohet reforma		
Kodi	Pyetjet	Përgjigjet
10.	Ka opinione që është i nevojshëm një rishikim i Kushtetutës. Në çfarë mase ju bashkoheni me këtë opinion:	1. Jam dakord 2. Nuk jam plotësisht dakord 3. Nuk jam dakord → përfundon pyetëso 4. Nuk e di 5. Refuzoj të përgjigjem
11.	A mendoni se rishikimi duhet të jetë:	1. I plotë - shko te pyetja 10 2. I pjesshëm - vazhdon pyetja 9

		3. Nuk e di/ Refuzoj të përgjigjem
12.	A nënkupton kjo rikthimin e Kushtetutës para ndryshimeve të miratuara në vitin 2008?	1. Po 2. Jo 3. Nuk e di/ Refuzoj të përgjigjem
13.	Cilat aspekte të Kushtetutës mendoni se duhen rishikuar (zgjidh më shumë se një opsion?):	1. Modeli parlamentar i qeverisjes; 2. Sistemi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve; 3. Pozita kushtetuese e Presidentit të Republikës; 4. Emërimi i anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese; 5. Rregullimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së pushtetit gjyqësor; 6. Dispozitat lidhur me Këshillin e Ministrave; 7. Emërimi dhe pozita kushtetuese e Prokurorit të Përgjithshëm dhe sistemit të prokurorisë; 8. Pozicioni dhe garancitë kushtetuese të institucioneve të pavarura; 9. Rregullimi i organizimit të pushtetit vendor; 10. Procesi ligjvënës; 11. Kreu mbi referendumin 12. Të tjera (specifiko)_____
Seksioni II – Procedura që duhet të ndiqet për ndryshimin e Kushtetutës		
Kodi	Pyetjet	Përgjigjet

14.	Cila prej procedurave të parashikuara në Kushtetutë, ju duket më e përshtatshme për amendimin e saj:	1. Votimi në Kuvend me shumicën prej 2/3 të anëtarëve të tij; 2. Votimi në Kuvend me shumicën prej 2/3 të anëtarëve të tij për hedhjen e amendamenteve në referendum; 3. Votimi në Kuvend me shumicën prej 2/3 të anëtarëve të tij dhe hedhja e amendamenteve në referendum me kërkesën e pakicës që i kundërshtoi ato.
15.	Cilët prej këtyre subjekteve, mendoni se duhet të përfshihet në procesin e diskutimit dhe hartimit të amendamenteve kushtetuese? (mund të zgjedhësh më shumë se një option)	1. Anëtarë të parlamentit aktual; 2. Anëtarë të parlamentit në legjislaturat e kaluara, ish-presidentë, ish-kryeministra; 3. Përfaqësues të qeverisë; 4. Përfaqësues të pushtetit gjyqësor; 5. Aktorë të tjerë të rëndësishëm si akademikë, konstitucionalistë dhe ekspertë të fushës; 6. Përfaqësues të grupeve të interesit; 7. Përfaqësues të shoqërisë civile; 8. Konsulentë të huaj; 9. Publiku i gjerë; 10. Të tjerë (specifiko)_____
16.	Në rast hipotetik, nëse maxhoranca parlamentare siguron numrin e mjaftueshëm të votave për miratimin e ndryshimeve kushtetuese, si e vlerësoni pjesëmarrjen e opozitës:	1. Shumë të rëndësishme; 2. Të rëndësishme; 3. Mjaftueshmërisht të rëndësishme; 4. Aspak të rëndësishme; 5. Nuk e di/ Refuzoj të përgjigjem.

17.	Cila ju duket struktura më e përshtatshme për administrimin e procesit të amendimit të Kushtetutës?	1. Komisioni parlamentar i Ligjeve; 2. Një komision parlamentar i posaçëm me pjesëmarrje të barabartë nga forcat politike; 3. Këshilli i Ministrave; 4. Një organizatë ndërkombëtare; 5. Tjetër (specifiko) _____
18.	Cili institucion/aktor mendoni se duhet të kryejë administrimin e marrëdhënieve me publikun gjatë procesit të diskutimeve për rishikimin e Kushtetutës?	1. Aktor i shoqërisë civile; 2. Institucion shtetëror; 3. Parlamenti; 4. Organizëm ndërkombëtar; 5. Tjetër _____ (specifiko)
19.	Cilat nga këto kritere ju duket e përshtatshme për të përcaktuar aspektet që duhen rishikuar në Kushtetutë? (mund të zgjedhësh më shumë se një opsion)	1. Problematika e vërejtur në zbatimin e Kushtetutës; 2. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; 3. Raportet dhe komentet e organizatave ndërkombëtare; 4. Kontributet akademike dhe përvoja e vendeve të tjera; 5. Raport progreset e Bashkimit European; 6. Të tjera (specifiko)
20.	Si e vlerësoni transparencën dhe informimin aktiv të publikut dhe grupeve të interesit për procesin e ndryshimeve kushtetuese?	1. Shumë të rëndësishme; 2. Të rëndësishme; 3. Mjaftueshmërisht të rëndësishme;

		4. Aspak të rëndësishme
Seksioni III – Propozime mbi ndryshimet potenciale kushtetuese		
Kodi	Pyetjet	Përgjigjet
	Pozita Kushtetuese e Presidentit të Republikës	
21.	A mendoni se duhet ndryshuar formula aktuale e zgjedhjes së Presidentit në funksion të forcimit të rolit të tij si një figurë e paanshme politikisht dhe garant i Kushtetutës?	- Po; - Jo; - Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem
22.	Cilin nga këto variante për zgjedhjen e Presidentit do ta vlerësonit të përshtatshëm për sistemin shqiptar?	- Zgjedhja e Presidentit nga tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit; - Zgjedhja e Presidentit drejtpërdrejtë nga populli; - Sipas formulës aktuale (në tri votimet e para zgjidhet President kandidati që merr jo më pak se 3/5 e gjithë anëtarëve të Kuvendit; në pamundësi të arritjes së këtij kuorumi, në votimin katërt dhe të pestë zgjidhet President kandidati që siguron më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit); - Tjetër (specifiko); - Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem
23.	A mendoni se duhet të ndryshojnë kompetencat kushtetuese të Presidentit të Republikës?	- Po, duhet të jenë më të zgjeruara; - Po, duhet të jenë më të kufizuara; - Jo; - Nuk e di/ Refuzoj të përgjigjem
	Kuvendi dhe reforma parlamentare	

24.	A mendoni se ka nevojë për forcimin e rolit mbikqyrës të parlamentit ndaj qeverisë?	1. Po; 2. Jo; - shko te pyetja 23 3. Nuk e di/ Refuzoj të përgjigjem
25.	A mendoni se bi-kameralizmi (parlamenti dy dhomësh) mund të jetë më efikas për kontrollin e qeverisë, duke e bërë opozitën më pjesëmarrëse në jetën parlamentare?	1. Po; 2. Jo; 3. Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem
Mocioni i besimit të Kryeministrit		
26.	Në rast se mocioni i besimit i paraqitur në Kuvend nga Kryeministri votohet nga më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, ai ka të drejtë t'i kërkojë Presidentit të Republikës shpërndarjen e Kuvendit. Sipas këtij parashikimi mendoni se:	1. Është forcuar pozita e Kryeministrit në dëm të qëndrueshmërisë së qeverisjes; 2. Është rritur standardi politik dhe stabiliteti në vend; 3. Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem
27.	Cili mendoni se është sistemi më i përshtatshëm për çështjen e mocionit të besimit/mosbesimit të Kuvendit ndaj Kryeministrit:	1. Në qoftë se Kryeministri e humbet votëbesimin dhe Kuvendi nuk është në gjendje të miratojë menjëherë një Kryeministër të ri, vendi shkon në zgjedhje të reja (sistemi aktual); 2. Në qoftë se Kryeministri e humbet votëbesimin, Kuvendi ka një hapësirë kohore për të zgjedhur një Kryeministër të ri (sistem i mëparshëm); 3. Në qoftë se Kryeministri e humbet votëbesimin, ai qëndron në detyrë deri në zëvendësimin e tij nga Kryeministri tjetër i ri; 4. Nuk e di/ Refuzoj të përgjigjem

	Emërimi i organeve kushtetuese	
28.	Sipas sistemit aktual kushtetues, zgjedhja e gjyqtarëve kushtetues dhe të lartë si dhe Prokurorit të Përgjithshëm, (megjithëse bazohet në sistemin e përzier President - Kuvend) realizohet me një minimum prej 36 votash të deputetëve të Kuvendit. Mendoni se kjo formulë duhet ndryshuar 1. Zgjedhja e gjyqtarëve kushtetues? 2. Zgjedhja e gjyqtarëve të Gjykatës së lartë? 3. Zgjedhja e Prokurorit të përgjithshëm?	1.Po 2. Jo 3. Nuk e di/rezujtoj të përgjigjem 2.Po 2. Jo 3. Nuk e di/rezujtoj të përgjigjem 3.Po 2. Jo 3. Nuk e di/rezujtoj të përgjigjem
29.	Mendoni se formula e zgjedhjes me një shumicë të cilësuar është e përshtatshme për: 1. zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues? 2. zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës së lartë? 3. zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm?	1. Po 2.Jo 3. Nuk e di/rezujtoj të përgjigjem 2. Po 2.Jo 3. Nuk e di/rezujtoj të përgjigjem 3. Po 2.Jo 3. Nuk e di/rezujtoj të përgjigjem
30.	A mendoni se verifikimi kushtetues duhet të gjykohej nga : 1. Gjykata Kushtetuese 2. Një koleg i veçantë i Gjykatës së Lartë?	1. Po 2. Jo 3. Nuk e di/ rezujtoj të përgjigjem 2. Po 2. Jo 3. Nuk e di/ rezujtoj të përgjigjem
31.	A mendoni se Gjykata Kushtetuese duhet të shqyrtojë paraprakisht propozimet për amendimin e Kushtetutës?	1.Po 2.Jo 3. Nuk e di/ rezujtoj të përgjigjem të përgjigjem
32.	A mendoni se formula aktuale e përbërjes së Këshillit të Lartë të	1.Po

	Drejtësisë është e përshtatshme për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së pushtetit gjyqësor?	2.Jo 3.Nuk e di/ refuzoj të përgjigjem
33.	Shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë përbëhet nga gjyqtarë. A mendoni se ka nevojë për një ribalancim të forcave brenda Këshillit të Lartë të Drejtësisë?	1. Po 2. Jo 3. Nuk e di/Refuzoj të përgjigjem
34.	Sipas opinionit tuaj, a duhen ndryshuar kompetencat e Këshillit të Përgjithshëm të Prokurorisë?	1.Po, kompetencat e këtij mekanizmi duhen forcuar e zgjeruar; 2.Po, kompetencat e këtij mekanizmi duhen kufizuar ; 3.Jo; 4.Nuk e di/ refuzoj të përgjigjem
Klauzola e dispozitave kushtetuese të paprekshme		
35.	Disa kushtetuta kanë të parashikuar ndalimin për të ndryshuar disa dispozita që lidhen me të drejtat e njeriut dhe parimet themelore. A mendoni se ato duhet të jenë pjesë edhe e Kushtetutës sonë?	1.Po 2.Jo 3.Nuk e di / refuzoj të përgjigjem

JU FALEMINDERIT!

Komente të intervistuesit: _____

Aneksi 2: Komente të të intervistuarve:

- *“Lidhur me pyetjen 31: “Mendoj se jo, por një anëtar i saj mund të jetë në Komisionin e Amendimit”. Kushtetuta është një akt themeltar, i cili në opinionin tim duhet të jetë shumë pak i ndryshueshëm dhe shumë pak i amendueshëm. Ndryshimet e saj apo të kuadrit ligjor, këtu bëhen në funksion të interesave politike të forcës politike në pushtet dhe në eksperiencën time nuk kam hasur ndryshime ligjore në funksion të forcimit të institucioneve shtetërore, garantimit të të drejtave themelore. Gjithcka bëhet në funksion të interesave të momentit të atyre që janë në pushtet. Nuk e shoh si të domosdoshme amendimin e Kushtetutes, por garantimin e saj, zbatimin korrekt të legjislacionit aktual.”*
- *“E vlerësoj pyetësin dhe besoj që do të jetë një prioritet aktual reforma kushtetuese.”*
- *“ Ndryshimet kushtetuese janë shumë të nevojshme.”*
- *“ Pyetësi, mjaft konciz.”*
- *“Shpresoj për një reformë serioze.”*
- *“Vendosja e një reforme dhe arritje për sukses në drejtësi, bazohet në parimin e barazisë dhe lirisë së institucioneve.”*
- *“Mendoj se pyetjet ishin të përshtatshme me problematikat e kohës”*
- *“Rishikimi kushtetues pa anketa dhe sondazhe,të vrojtohen në nivel shtetëror problemet kushtetuese , të krijohet një mekanizëm jashtë politikës që dërgon kandidaturën në parlament dhe te presidenti, përdorimin e elementit rastësor,pra me short. Duhet ndryshim në Sistemin zgjedhor ndoshta propocional-mazhoritar dhe Kriteret për zgjedhjen e deputetëve të ndryshojnë, figura e tij, duhet parë me kujdes për të rritur integritetin. ”*
- *“Eshtë shumë e rëndësishme që të rishikohen ndryshimet kushtetuese të vitit 2008, të cilat kanë sjellë një deformim të demokracisë përfaqësuese dhe rritjen e klientelizmit në politikë”*
- *“ Për pyetjen 26: listat e mbyllura,mocioni i besimit,partitë inekzistente,jokufizim i mandateve të kryetarit duhet të jenë superprioritet*
Për pyetjen 33: juritë qytetare + impeachment dhe ridimensionim i KLD, vetëm për transferime
Për pyetësin: Me gabime dhe nuk prek sa duhet demokracinë popullore dhe instrumentat”
- *“ Realizimi i reformës kushtetuese është shumë i domosdoshëm për vendin tonë. ”*
- *“ Reforma duhet të jetë një prioritet aktual në vend. ”*